VENDIM
Nr. 181, datë 4.4.2019

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 e 18, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.208, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të institucioneve të tjera qeveritare, për vitin 2019, shtohet me 5 (pesë) veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të këtyre institucioneve në 1 119 (një mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) punonjës. Ndryshimi i numrit të punonjësve të institucioneve të tjera qeveritare është, përkatësisht,:

a) Qendra e Botimeve për Diasporën shtohet me 2 (dy) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të këtij institucioni në 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës;

b) Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit reduktohet me 3 (tre) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Agjencisë në 41 (dyzet e një) punonjës;

c) 6 punonjës për Sekretariatin Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar.

2. Numri i punonjësve të Kryeministrisë reduktohet me 6 (gjashtë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Kryeministrisë në 150 punonjës.

3. Numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave shtohet me 6 (gjashtë) punonjës, për vitin 2019, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në 5 809 (pesë mijë e tetëqind e nëntë) punonjës.

4. Numri i punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë reduktohet me 14 (katërmbëdhjetë) punonjës, të cilët nuk janë punonjës organikë, por i përkasin mjekëve specializantë, që përfundojnë kontratat e specializimit pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Numri total i punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë bëhet 5 629 (pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) punonjës.

5. Numri i punonjësve të Institutit të Shëndetit Publik reduktohet me 2 (dy) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në 4 257 (katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) punonjës.

6. Numri i punonjësve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2019, shtohet me 3 (tre) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 929 (nëntëqind e njëzet e nëntë) punonjës.

7. Numri i papërdorur prej 8 (tetë) punonjësish kalon në shtimin e numrit rezervë të punonjësve të institucioneve qendrore, duke e çuar këtë numër në 24 (njëzet e katër) punonjës.

8. Në programin "Shërbime të tjera", për Sekretariatin Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, shtohet fondi prej 7 000 000 (shtatë milionë) lekësh për shpenzime personeli dhe shpenzime operative, për vitin 2019.

9. Në institucionin e Kryeministrisë, në programin "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi" reduktohet fondi prej 7 000 000 (shtatë milionë) lekësh, në zërin "Shpenzime korrente", për vitin 2019.

10. Ngarkohen institucionet e përmendura në këtë vendim të paraqesin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ndryshimet e numrit të punonjësve dhe fondeve përkatëse buxhetore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama